

PROGRAMI INSTITUCIONAL I TRANSPARENCËS I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT

I. Hyrje

Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është përgatitur programi i transparencës për Institucionin, Drejtorinë e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

Ky program përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së autoritetit në kuadër të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit” (LDI).

Ky program vlerësohet si mënyrë konkrete përmes së cilës Autoritetit Publik (këtej e tutje DPRMSH) ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nën garancinë e LDI-së.

DPRMSH do të përditësojë herë pas here Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2, të nenit 5 të LDI-së.

Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së DPRMSH-së, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.dprms.gov.al si dhe mjediset e zyrave të saj.

Programi i transparencës pasqyrohet në rubrika, tekste/përmbajtje, afat kohor për bërjen publike të tij, mënyrën e bërjes publike si dhe strukturën përkatëse e cila prodhon ose administron dokumentacionin e veprimtarisë së DPRMSH-së.

Në përmbajtje të programit të transparencës evidentohet skema e publikimit, e cila pasqyron menutë ku adresohet dokumenti në faqen zyrtare në internet.

Përveç kësaj, çdo dokument është i aksesueshëm edhe në skemë.

Dokumentacioni i bërë publik, do të jetë i përditësuar në formë e përmbajtje. Faqja zyrtare e DPRMSH-së është ndërtuar në atë formë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm.

Në rubrikat e faqes zyrtare pasqyrohen edhe informacione që karakterizohen nga kufizime të identifikimit të të dhënave personale për shkak të ruajtjes së privatësisë së individëve/subjekteve.

II. Parime të përgjithshme

Parimet kryesore në të cilat mbështetet Programi i Transparencës së DPRMSH-së janë si më poshtë:

“E drejta për informim” është e drejtë kushtetuese e parashikuar në nenin 23 të saj, e aksesueshme nga të gjithë pa përjashtim.

Prezumimi i publikimit maksimal të të dhënave: DPRMSH ushtron funksione publike, për rrjedhojë informacioni që rrjedh nga veprimtaria e tij publikohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Zbatimi korrekt i ligjit dhe dispozitave ligjore që rregullojnë në mënyrë të posaçme veprimtarinë e DPRMSH-së, dhe përkatësisht: Ligji Nr.9900, dt. 10.04.2008 “Për Rezervat

Materiale të Shtetit”, VKM Nr.1128, dt. 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë materiale shtetërore”.

Informacioni përshtatet në gjuhë të qartë e të kuptueshme.

Organi mbikqyrës i procedurave të informimit publik është Titullari i Institucionit.

Rishikimi i programit të transparencës bëhet sipas së njëjtës procedurë, përmes së cilës është bërë miratimi i tij.

Informacioni publik pa kërkesë duhet të jetë:

- ✓ I plotë
- ✓ I saktë
- ✓ I përditësuar
- ✓ I thjeshtë në konsultim
- ✓ I kuptueshëm
- ✓ Lehtësisht i aksesueshëm
- ✓ I pajtueshëm me dokumentet origjinale në posedim të autoritetit publik.

III. Informacioni që bëhet publik pa kërkesë

Informacioni i lejuar për publikim është shprehimisht i parashikuar në nenin 7 të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”.

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, DPRMSH vendos në dispozicion të publikut në faqen e tij të internetit www.dprmshe.gov.al, dhe në zyrat e saj kategoritë e mëposhtme të informacionit:

1. Strukturën organizative të Institucionit.
2. Të dhënat për vendodhjen e Institucionit dhe degëve rajonale të tij.
3. Të dhënat mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Institucionit.
4. Tekstet e plota të Kushtetutës, të Ligjit Nr.9900, dt. 10.04.2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, të VKM Nr.1128, dt. 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë shtetërore”, Rregulloren e Brendshme të DPRMSH-së, Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar me Ligjin Nr.9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr.10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012 dhe Ligjin Nr.131/2012 “Për Prokurimet Publike”, Ligjin Nr.9874, datë 14.2.2008 “Për ankandin publik”, Udhëzimin Nr.75, datë 13.03.2014 “Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit” dhe Udhëzimin Nr.1, datë 18.02.2015 “Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH”.
5. Informacion të plotë dhe të përditësuar mbi ndihmat e dhëna nga DPRMSH-ja, mbi ankandet e publikuara dhe prokurimet.
6. Faqja zyrtare e DPRMSH është ndërtuar në atë formë që mundëson jo vetëm aksesin në informacion por edhe mundësinë që publiku të paraqesë ankesat e tij.
7. Informacion mbi Koordinatorin për të drejtën e informimit.
8. Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve.

Nr	Kategoritë e informacioni publik pa kërkesë	Baza ligjore	Dokumenti/përmbajtja	Afati kohor për publikun	Mënyra e publikimit	Sektori Përgjegjës për përgatitjen e materialit apo disponimin e tij
1	Përshkrimi i strukturës organizative, funksioneve dhe organika e DPRMSH	Urdhrin e Kryeministrit Nr.78, datë 21.02.2014	Urdhër/ Skemë organizative, organika	Pas botimit në fletoren zyrtare	www.dprmsh.gov.al Menu- organigrama Normativa- Urdhra	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
2	Të dhënat për vendndodhjen e Instiucionit dhe degëve rajonale të tij	Ligji Nr.9900 datë 04.10.2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”	Të dhëna		www.dprmsh.gov.al Menu- Rreth Nesh – Vendndodhjet e rezervave, Drejtoritë Rajonale të DPRMSH	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme
3	Të dhënat mbi detyrat dhe përgjegjësitë e Institucionit	Ligji Nr.9900 datë 04.10.2008 “Për Rezervat Materiale të Shtetit”, VKM Nr.1128, datë dt. 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrarezervës shtetërore”, Rregullorja e brendshme e DPRMSH, Udhëzimin nr. 75, datë 13.03.2014 "Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në	Ligji , VKM, Udhëzime, Rregullore e Brendshme	Pas botimit në fletoren zyrtare	www.dprmsh.gov.al Menu- Rreth Nesh- Detyrat dhe Përgjegjësitë e DPRMSH, Rezervat materiale të Shtetit www.dprmsh.gov.al Menu-Normativa – Ligji për DPRMSH, Rregullore e brendshme, VKM	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

		<i>Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit", Udhëzimi nr. 1, datë 18.02.2015 "Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH".</i>				
4	Tekstet e plota të akteve ligjore mbi bazën e të cilave vepron institucioni	Kushtetuta e Shqipërisë, Ligji Nr.9900, dt. 10.04.2008 "Për Rezervat Materiale të Shtetit", VKM Nr.1128, dt. 05.08.2008 "Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë shtetërore", Rregulloren e Brendshme të DPRMSH-së, Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar, Ligjin Nr.9874, datë 14.2.2008 "Për ankandin publik", Udhëzimi Nr.75, datë 13.03.2014 "Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat	Kushtetuta, Ligje, VKM, Udhëzime, Rregullore e Brendshme	Pas botimit në fletoren zyrtare	www.dprmshe.gov.al Menu-Normativa – Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji për DPRMSH, Rregullore e brendshme, VKM	Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve të Brendshme

		<i>Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit", Udhëzimi Nr. 1, datë 18.02.2015 "Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH".</i>				
5	Informacion të plotë dhe të përditësuar mbi ndihmat e dhëna nga DPRMSH-ja, mbi ankandet e publikuara dhe prokurimet	Ligji Nr.9900, dt. 10.04.2008 " <i>Për Rezervat Materiale të Shtetit</i> ", Ligjin Nr.9874, datë 14.2.2008 " <i>Për ankandin publik</i> ", VKM Nr.1128, dt. 05.08.2008 " <i>Për krijimin dhe administrimin e mallraverезervë shtetërore</i> ", Udhëzimi Nr.75, datë 13.03.2014 " <i>Për procedurat që ndiqen për administrimin e automjeteve dhe motomjeteve që kalojnë në Rezervat Materiale të Shtetit si pasojë e konfiskimit</i> ", Udhëzimi Nr.1, datë 18.02.2015 " <i>Për mënyrën e marrjes në dorëzim të mallrave nga DPRMSH</i> ".	Të dhëna të përditësuara	Përditësim i të dhënave	www.dprmsh.gov.al Menu- Ankande dhe Prokurime	Personi përgjegjës për administrimin e sitit, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm

6	Ankesat	Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Ligji, të dhëna	Pas miratimit nga Koordinatori për të drejtën e informimit	www.dprmsh.gov.al Menu- Ankesat	Koordinatori për të drejtën e informimit
7	Informacion mbi Koordinatorin për të drejtën e informimit	Ligji Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Të dhëna	Pas miratimit nga Koordinatori për të drejtën e informimit	www.dprmsh.gov.al Menu- Programi i Transparencës- Koordinatorin për të drejtën e informimit	Koordinatori për të drejtën e informimit
8	Rregjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Neni 8 i Ligjit Nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”	Tabelë	Pas miratimit të Programit të Transparencës	www.dprmsh.gov.al Menu- Programi i Transparencës	Koordinatori për të drejtën e informimit

V. PUBLIKIMI

Në përputhje me këtë program transparence të miratuar, DPRMSH vendos në dispozicion të publikut në faqen e saj në internet www.dprmsh.gov.al dhe në mjediset e zyrave të saj për takime me publikun, kategoritë e mësipërme në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës”.

VI. MONITORIMI

Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit monitoron zbatimin e ligjit për rezervat materiale të shtetit, aktet nënligjore në zbatim të tij dhe të drejtën e informimit, duke nxitur parimin e transparencës në punën e saj, veçanërisht duke sensibilizuar dhe informuar për çështje që lidhen me shërbimet funksionale të DPRMSH-së.